

V E N D I M
Nr.613, datë 13.12.1993

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NDËRTIM DHE PROJEKTIM TË SHOQËRIVE

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Çdo shoqëri vendase dhe e huaj, ose shoqëri me kapital të përbashkët, që do të ushtrojë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe projektimit, duhet të regjistrohet në regjistrin themeltar të Komisionit të posaçëm për dhënien e liçensave profesionale pranë sektorit të liçencave të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, duke paraqitur dokumentet përkatëse si më poshtë:

a) Kërkesën me shkrim, ku të paraqitet një autobiografi e shkurtër për veprimtarinë si shoqëri dhe për veprimtarinë që do të ushtrojë.

b) Liçencën profesionale për ushtrimin e veprimtarisë. Kjo vetëm për shoqëritë e huaja që ushtrojnë veprimtari në vendin e tyre në fushën e ndërtimit.

c) Statutin e shoqërisë.

ç) Aftësinë ndërtuese që ka shoqëria, ku të përfshihen mjetet, fuqia punëtore dhe aftësia teknike.

d) Kredibiliteti nga ana financiare. Kjo vetëm për shoqëritë e huaja ose ato me kapital të përbashkët.

dh) Deklaratë, ku të thuhet se njeh dhe do të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP, KTZ, STASH-et dhe ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit.

e) Të deklarojë që merr përsipër të dërgojë informacion në Ministrinë e Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit çdo tre muaj për veprimtarinë e shoqërisë, objektet, realizimin në lekë dhe numrin e fuqisë punëtore si kusht i domosdoshëm për rinovimin e liçencës.

2. Shoqëria shqiptare ose e huaj apo shoqëria me kapital të përbashkët që nuk është pajisur me dokumentin e regjistrimit në regjistrin themeltar të ndërmarrjeve, nuk ka të drejtë të ushtrojë veprimtari në fushën e ndërtimit e të projektimit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi